



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 153 datë 09.11.2020

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.6, DATË 05.02.2020 PROJEKTI “SHPORTA E BEBES”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, si dhe në vijim të memos së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale me nr. 31052/1, prot 29.10.2020, si dhe me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr.6, datë 05.02.2020 të Këshillit Bashkiak projekti “Shporta e bebes” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

1.1 “Shporta e bebes” do të përfitohet nga prindi/prindërit pranë materniteteve publike “Mbretëresha Geraldine” dhe “Koço Glozheni.

2. Përyjashtimisht të porsalindurit në maternitetin publik “Mbretëresha Geraldine” dhe “Koço Glozheni”, për periudhën 1 Shkurt – 28 Tetor 2020, do të përfitojnë vlerën 5.000 lekë (pesëmijë lekë).

3. Për të përfituar sipas pikave 1.1 dhe 2 të këtij vendimi, duhet që të paktën njëri nga prindërit të jetë me vendbanim të përhershëm në Bashkinë Tiranë, vërtetuar sipas dokumentacionit të gjendjes civile.

4. Efektet financiare të pikës 2 të këtij vendimi do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, bonus për fëmijë në “Programin e Kujdesit Social për familjet dhe fëmijët” .

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Njësitë Administrative dhe Lagjet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

K R Y E T A R

T O N I G O G U